

## MBLEDHJA E PËRBASHKËT SHQIPËRI - KOSOVË INTEGRIMI I TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Enti Rregullator i Energjisë për Shqipërinë (ERE) u mirëprit sot, më 27 dhjetor 2022, nga Zyra e Rregullatorit për Energji për Kosovën (ZRRE), në ambjentet e Hotelit “*Four Points by Sheraton*” në Prishtinë, në një mbledhje të përbashkët me qëllim shqyrtimin e Rregullave dhe Procedurave të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) dhe miratimin e tyre.

Gjatë fjalës së tij Kryetari i ERE, Z.Petrit Ahmeti, e quajti këtë mbledhje një ogur të mirë për vijimin e bashkëpunimit midis të dy rregullatoreve, me besimin që takime të tilla me tematike të përbashkët që do ti shërbejnë rritjes së këtij bashkëpunimi dhe në vijim sfidave që i dalin të dy rregullatorëve në operimin e suksesshëm të këtij tregu.

Miratimi i këtyre rregullave i hap rrugën bërjes efektive të platformës së tregtimit dhe është një hap i madh përpara në krijimin e tregut rajonal të energjisë të Ballkanit Perëndimor. Nga efikasiteti i saj do të përfitojnë konsumatorët e Kosovës dhe Shqipërisë por edhe i tërë rajoni si pjesë e iniciativave të përbashkëta. Në këto kohë të sfidave të shtuara të sektorit të energjisë, jemi të kënaqur me progresin që ALPEX-i ka bërë dhe falënderojmë homologët tanë nga Shqipëria për kontributin dhe mbështetjen e tyre.“ tha Z.Ymer Fejzullahu, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të ZRRE-së.



Bordi i ERE me Vendimin e datës 27.10.2022, i hapi rrugën realizimit të këtij takimi pasi vendosi “Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Shoqërisë ALPEX sh.a., dhe të OST sh.a., “Për Miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike” në vijim të së cilës u zhvilluan seanca konsultative të përbashkëta me palët e interesuara në këtë proces ku u diskutuan këto rregulla dhe mendimet apo sugjerimet e palëve mbi to.

Finalizimi i këtij procesi është paraprirë nga memorandumet e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve të sistemeve të transmetimit OST, KOSTT, enteve rregullatore ERE dhe ZRRE për bashkimin e tregut të energjisë elektrike për ditën në avancë. Në linjë me Memorandumin e Mirëkuptimit të WB6, në datën 21 tetor 2021 u nënshkrua një tjetër Marrëveshje Kornizë midis OST, KOSTT, ERE dhe ERO për bashkimin (coupling) e tregut të ditës në avancë të energjisë

elektrike dhe brenda së njëjtës ditë. Shqipëria dhe Kosova nënshkruan Marrëveshjen Kornizë si dhe marrëveshje të tjera të suksesshme, të nevojshme për operimin e bashkimit të tregut të ditës në avancë dhe atë brenda së njëjtës ditë.

Qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës janë palë nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë



dhe janë zotuar në krijimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues dhe transparent të energjisë elektrike, ndaj modelet e tregjeve në të dyja vendet parashikojnë që nëpërmjet ALPEX të zbatohet Modeli i Synuar Evropian i Tregut. Fillimisht tregu i ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë është parashikuar të krijohet me dy zona ofertimi, në Shqipëri dhe Kosovë duke synuar në të ardhmen projekte për bashkimin me tregje të tjera potenciale.

ALPEX pritet të fillojë me operimin e tregut të ditës në avancë në Shqipëri, dhe më pas, brenda një periudhë dy mujore do të operojë me bashkimin e këtij tregu me tregun e Kosovës. Ndërkohë parashikohet që në muajt në vijim AlpeX të fillojë trainimin e tregtarëve për tregtimin në treg si dhe të fillojë procesi i Dry Run gjatë së cilit do të shihen dhe mënyra e funksionimit të këtij tregu si dhe njohja e palëve me proceset e tregtimit të produkteve në këtë bursë.

Roli i rregullatorëve të të dy vendeve tona do të jetë mbikqyrja e këtij procesi dhe përfundimi i tij me sukses për të përmbushur detyrimet e ndërmarra nga Shqipëria në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Ky proces u mbështet nga USAID, partner strategjik i të dy enteve rregullatore ERE dhe ZRRE.